



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 361/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), dega në Graçanicë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) në Zveçan, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 16.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) dega Graçanicë.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 14.06.2014, nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), dega në Graçanicë, në të cilën theksohet se nga raporti i KQZ-së lidhur me publikimin e rezultatit preliminar, si dhe duke pasur qasje në rezultatet zgjedhore të publikuara për vendvotimin 2901B/06D për komunën e Zveçanit konstatojnë se numri i nënshkrimeve në LPV dhe numri i fletëvotimeve të cilat gjenden brenda kutisë së votimit me nr 121, numri total i fletëvotimeve është 417, numri i fletëvotimeve të pavlefshme është 1, prej të cilave një subjekt politik i ka fituar gjithsejtë 405 votat që nuk ekzistojnë. Parashtruesi i ankesës thekson se e gjithë kjo tregojnë qartë se me një sjellje të pandërgjegjshëm, manipulative dhe kriminale e anëtarëve të KVV-së në këtë vendvotim është tentuar të manipulohet procesi zgjedhor me qëllim të rritjes së numrit të votave për një subjekt politik duke i dëmtuar subjektet e tjera politike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon që të rishqyrtohen dhe të anulohet procesi zgjedhor në të gjitha vendvotimet në komunën e Zveçanit me qëllim të konstatimit të shkeljeve dhe keqpërdorimeve të bëra.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

A nr. 361/2014 më datën 16.06.2014

**Kryesuesi i Panelit**

**Hasan Shafa**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.